

VENDIM
Nr. 136, datë 22.2.2017

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË SIPËRFAQES NË
NGASTRAT 41A, 42
DHE 43A, NË OBJEKTIN E QUAJTUR “BISTRICË”, TË EKONOMISË PYJORE
“DHROVJAN”, DELVINË, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “DELGI”, SH.P.K.,
PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË GIPS ALABASTERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 29.4 ha, pjesë e ngastrave 41a, 42 dhe 43a, në objektin e quajtur “Bistricë”, të ekonomisë pyjore “Dhrovjan”, Delvinë, që do të përdoret nga shoqëria “Delgi”, sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të gips alabastrit, të hiqet nga fondi pyjor dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për ngastrat pyjore dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt mineralar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të sipërfaqes së hequr dhe të pakësimit në volum të lëndës drusore, paguhen nga shoqëria “Delgi”, sh.p.k., në bazë të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Delgi”, sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda 3 viteve të para, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe prej 29.4 ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Bashkinë Finiq.

4. Bashkia Finiq dhe shoqëria “Delgi”, sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshje të përbashkët për hapat, afatet dhe procedurat për hartimin dhe realizimin e projekteve teknike sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas lidhjes 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullosore”, dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet mineralar”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit, sipas lejes mjedisore, nga shoqëria “Delgi”, sh.p.k. sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor publik.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Finiq dhe shoqëria “Delgi”, sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR NGA SHOQËRIA "DEGLI" sh.p.k. në qarkun e VLORËS

QARKU Vlore

Lidhja 1

ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullosore	Ngastra	Perdorimi territorit	Administrimi	Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)
VL 27 0 041 a	Dhrovjan	41 a	shkurre	Ministria Mjedisit	14
VL 27 0 042	Dhrovjan	42	shkurre	Ministria Mjedisit	4.2
VL 27 0 043 a	Dhrovjan	43 a	shkurre	Ministria Mjedisit	11.2
GJITHSEJ					29.40

